



KarateZeon[®] 5 CS

Lënda vepruese: Lambda-cyhalothrin
PËRMBAJTJA: Lambda-cyhalothrin: 5%
Lëndë ndihmëse: 95%
Numri i regjistrimit: AL: 87/1-14.11.2008
KS: 010-119-2009/31.12.2009
Formulimi: Suspension kapsulash

INSEKTICID PIRETROID ME SPEKTËR TË GJERË VEPRIMI E PËRDORIMI. VEPRON NËPËRMJET KONTAKTIT DHE APARATIT TRETËS

PËRDORIMI:

a) KULTURAT BUJQËSORE: Pemë frutore, Ulli, Agrume, Vresht, Bimë të arave dhe Perime.

b) DËMTUESIT: Përdoret për luftimin e insekteve që futen në rendet: Coleoptera, Lepidoptera, Hemiptera, Diptera, Orthoptera dhe Thysanoptera. Paralelisht ul popullatat e akarjeve tek pjeshka, vreshti, pambuku, perimet dhe shumë shpesh edhe tek molla. Vepron nëpërmjet kontaktit dhe aparatit tretës.

c) DOZA: Zakonisht përdoret 20 ml preparat për 100 litra ujë. Për luftimin e buburecit të patates dhe tenjës së ullirit doza ulet në 15 ml preparat për 100 litra ujë. Për luftimin e pleshtit të dardhës doza rritet në 40 ml preparat për 100 litra ujë. Doza më e lartë 40-50 ml preparat për 100 litra ujë përdoret për luftimin e krimbit të boçes dhe krimbit të kuq në pambuk dhe në perimet.

ç) SASIA E TRETËSIRËS SPËRKATËSE PËR 1 DYNIM:

- Në pemët frutore, ulli, agrume dhe vresht 100-200 litra.
- Në kulturat e tjera 50-100 litra.

MËNYRA E PËRDORIMIT: Me spërkatje, gjatë së cilës duhet të sigurohet lagje e mirë bimëve (deri sa të filloj të pikoj në tokë).

KOHA E SPËRKATJES: Spërkatjet duhet të bëhen sapo të duken shënjat e para të infeksionit. Kohëzgjatja e veprimit të KARATE-s në kushte infeksioni mesatar deri i madh zakonisht është 21 ditë.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:

Në perimet, pemët frutore, vresht dhe agrume: 7 ditë.

Në patate dhe grurë: 1 ditë.

Në misër, sojë, pambuk dhe ulli: 15 ditë.

Në lulediell: 21 ditë.

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik nëse përdoret me dozën e rekomanduar.

PËRZIHET me sukses me insekticidet dhe fungicidet e zakonshme.

PERIUDHA E RUAJTJES: 2 vjet.


MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin e produktit me gojën, lëkurën dhe sytë. -Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan. -Mbajeni në vende të sigurt, të ajrosura dhe larg fëmijëve. -Gjatë punës vishni pajisjet mbrojtëse. -Pas përfundimit të punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni. -Asgjësoni ambalazhin sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën lahu menjëherë me ujë të bollshëm dhe sapun. -Në rast kontakti me sytë i lani menjëherë me ujë të bollshëm për 10-15 minuta dhe drejtoheni tek mjeku. -Në rast gëlltitje mos provokoni artificialisht të vjella. Të sëmurin drejtoheni tek mjeku dhe i tregoni atij etiketën. Trajtimi mjekësor: Bëni lavazh të stomakut duke patur kujdes të evitoni thithjen e përmbajtjeve të tij. Jepini karbon aktiv dhe purgativ. Antidot nuk njihet.

Mjekim simptomatik. Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



MESATARISHT HELMUES PËR BLETËT.
KARATE i largon bletët.
Mos spërkatni bimët, pjalmimi i të cilave
varet nga bletët, 1 javë para lulëzimit.
HELMUES PËR PESHQIT
Mos zbrazni tepricat e tretësirës spërkatëse
në ujra.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Limited, Guildford,
Surrey GU2 7YH, UK.

Tel: + 44 1438 260 000, Fax: +44 1483 260 001.